



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

Komiteti për Komunitet

01 Nr.060/01-9476/2023

Gjakovë, me dt.17.05.2023, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit kati -4-

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e pestë e Komitetit për Komunitet për vitin 2023.

Të pranishëm ishin këta anëtarë të Komitetit për Komunitet: z. Ergit Qeli, znj. Ermira Morina, z. Nik Hiseni, z. Emrah Cermjani, znj. Ifeta Jakupi, znj. Lirianda Dahsyla, z. Leutrim Bala, znj. Shqipe Fejza, znj. Lerena Kameraj.

Mbledhjen e kryesoj kryesuesi i Komitetit për Komunitete: z. Ergit Qeli.

Të pranishëm tjerë: z. Shkumbim Kastrati Drejtori i drejtorisë së Infrastrukturës, z. Armend Behluli përfaqësues i ZKKK-së, përfaqësuesit nga OSBE-ja, dhe përfaqësuesit e mediave dhe të Zyrës për Informim.

Kryesuesi: Sot e kemi mbledhjen e pestë të Komitetit për Komunitete për vitin 2023 të pranishëm në këtë mbledhje jemi 9 anëtarët e komitetit, meqenëse ekziston Kuorumi po fillojmë me mbledhjen. Ftesën me rend dite e keni marrë me kohë andaj a ka dikush ndonjë diskutim sa i përket rendit të ditës.

Meqenëse nuk keni diskutime e qes në Votim rendin e ditës sipas ftesës që e keni marrë

Nga anëtarët e pranishëm unanimisht u votua pro rendit të ditës

Për këtë mbledhje u miratua ky:

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit të Komitetit për Komunitete.
2. Informatë nga drejtoria e infrastrukturës për implementimin e projekteve për vitin e kaluar dhe planet për vitin 2023.
3. Raporti i zyrës Komunale për Komunitet dhe Kthim (ZKKK).
4. Të ndryshme.

1.Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit të Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit të mbledhjes së fundit të komitetit për komunitete, hapi diskutimin nëse keni ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket këtij procesverbali.

Kryesuesi: Meqenëse nuk keni diskutime e qes në votim miratimin e procesverbalit nga mbledhja e fundit e mbajtur me dt. 17.04.2023, **Kush është Për, Kundër, Abstenim.**

Nga anëtarët e Komitetit për Komunitet Unanimisht u miratua Procesverbali.

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Informatë nga drejtoria e infrastrukturës për implementimin e projekteve për vitin e kaluar dhe planet për vitin 2023.

Kryesuesi: Informatë nga drejtoria e infrastrukturës për implementimin e projekteve për vitin e kaluar dhe planet për vitin 2023 një pjesë e anëtarëve të këtij komitet kemi vizituar disa lagja që kanë probleme me infrastrukturë ftuar drejtorin e infrastrukturës z. Kastrati që ta merr fjalën lidhur me këtë pik të rendit të ditës.

z. Shkumbim Kastrati: Fillimisht po ju njoftoj me projektet që janë zhvilluar në viti e kaluar siç e dini në vitin e kaluar kemi pasur problem të natyrave teknike për shkak të rritjes së çmimeve të artikujve bazë që prodhohen për infrastrukturë, ky problem ka qenë jo veç në komunën ton por në të gjitha komunat e Kosovës mirëpo në funde të viti kemi gjetur një kompromis dhe një pjesë e projekteve janë realizuar. Vitin e kaluar janë investuar një sasi e konsiderueshme e mjeteve financiare në lagjet ku preken direkt komunitet, kemi pasur edhe ndihmësen e qeveris me ndërtimin e rrugëve në mëhalle të Sefes, Dardani në Skivjan dhe tek stacioni i autobusëve gjithashtu në projektin për mbylljen e qendrës transfer që është para përfundimit ku do të bëhet gjelberimi dhe asfaltimi i rrugës. Për vitin 2023 në faqen e komunës është plani i prokurimin si dhe buxheti për vitin 2023 ku mund ti gjeni projektet e parapara për këtë vit p.sh. do të asfaltohen edhe disa rrugë në fshatin Skivjan përvëç projekteve që ju mund ti gjeni në buxhet kemi edhe dy kontrata kornizë, kontrata për sanimin e rrugëve me asfalt dhe kontrata për ndërtimin e rrugëve me kubëza prej të cilave kemi mundësi me intervenua edhe në lagjet ku jetojnë komunitetet. Drejtoria për infrastrukturë është në shërbimin e juaj andaj kërkoi që përmes emalit zyrtar ose me shkrim të drejtoheni për kérkesat e juaja dhe të kontaktoni ose të jeni në bashkëpunim me ZKKK-në në mënyrë që kérkesat të jenë zyrtare. Kërkoi nga ju që kur të mbahen dëgjimet buxhetore të merrni pjesë dhe ti prezantoni kérkesat dhe sugjerimet e juaja në mënyre që të përfshihen në buxhet në vitin e ardhshëm këto dëgjime buxhetore do të organizohen në muajin Korrik.

znj. Ifeta Jakupi: Për dëgjime buxhetore a janë të caktuara datat.

Kryesuesi: E falënderoj drejtorin për këto sugjerime unë personalisht do të marrë pjesë në dëgjimet buxhetore për vitin e ardhshëm kemi disa raste që pjesëtaret e komuniteteve kanë bërë kérkesë me shkrim për projekte të caktuara por asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje në ato kérkesa siç është rasti me projektin e rrugës Martirët Dinaj që kanë filluar punimet dhe kanë mbet në gjysmë dhe rruga është në gjendje shumë të keqe.

z. Shkumbim Kastrati: Ky projekt ka qenë i planifikuar të përfundoj në vitin e kaluar mirëpo pasi që kanë filluar punimet banoret e atyshëm kanë kérkuar që të bëhet ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe i gypave të ujësjellësit pra kjo na ka detyruar që ti ndërprenë punimet me kérkesë të komunitet mirëpo ky projekt do të realizohet dhe do të përfundojë këtë vit.

z. Shqipe Fejza: Për projektin e lagjes Ali Ibra që u tha se duhet me shikua nga ministria unë dua të di se cilat janë kompetencat e ministrisë a është ky projekt i ministrisë apo i komunës pra i kujt është projekti dhe kush i hap procedurat e tenderimit Rruga Bajram Avdyli në fshatin Bec

z. Shkumbim Kastrati: Segmenti i rrugës Ali Ibra dhe rrugës që të qon në Banesat Sociale është financuar nga ministria e infrastrukturës ndërsa procedurat e prokurimin i zhvillon komuna e Gjakovës mirëpo monitorimi i ekzekutimit dhe i pagesave është i përzier nga komuna e Gjakovës dhe ministria. Pra me projektet me bashkëfinancim janë dy forma të pagesave ku ka raste që ministria i derdh fondet në buxhetin e komunës për pagesën e projekteve të caktuara dhe forma tjetër që ministria i kërkon faturat nga komuna dhe i kryen pagesat.

z. Shqipe Fejza: Një rruge në fshatin Bec që është me rrezikshmëri të lartë sepse mungon trotuari a do të ketë këtë vit punime në këtë projekt.

z. Shkumbim Kastrati: Në fshatin Bec do të ketë projekte edhe në këtë vit dhe ato rrugë që e kanë të planifikuara trotuarin do të bëhet realizimi i tyre, në rrugën Lek Dukagjini ka qenë një projekt në vlerë 90 mijë euro pas shumë përpjekje kemi arrit në një marrëveshje me bashkëfinancim me qeverinë e cila është lidhur në muajin Gusht dhe pas zhvillimit të procedurave te tenderimit kemi arritur në muajin Nëntor që praktikisht është e pamundshme të realizohet projekti për shkak të motit ndërsa me datën 10 Dhjetor na ka ardhur një shkresë nga ministria se nëse nuk realizohet ky projekt brenda këtij viti do të tërhiqen nga bashkëfinancimi e kjo nuk ka qenë aspak korrekte sepse ne kemi arritur vetëm 10 % të punimeve për ti kryer dhe janë tërhequr mjetet nga qeveria pa pasur konsideratë që fizikisht ka qenë e pamundur të kryhen këto punime.

z. Ifeta Jakupi: E falënderoj drejtorin për këto informata mirëpo pyetje ime është a do të realizohet këtë vite projekti për urën në Rogovë.

z. Shkumbim Kastrati: Ura në Rogovë është në rrezikshmëri shume të larte ne në bashkëpunim me policin e kemi ndalur qarkullimin mirëpo personat e pandërgjegjshëm i kanë hequr bllokadat edhe përkundër rrezikut qytetarët qarkullojnë mbi atë urë, komuna e Gjakovës nuk ka kapacitet për ndërtimin e asaj ure kemi pretime nga ministria e infrastrukturës dhe kemi marrë zotimin se ajo urë do të realizohet mirëpo kanë pasur disa problem me kontratën për hartimin e projektit ne jemi në kontakt të vazhdueshme me përfaqësuesit e ministrisë dhe do të angazhohemi në vazhdimesi për gjetjen e një zgjidhje për ndërtimin e kësaj ure. Në takimin e fundit që kemi pasur me përfaqësuesit e ministrisë ka mbetur që të kemi edhe një takim me ministrin dhe kryetarin komunës lidhur me këtë projekt.

z. Emrah Cermjani: E falënderoj drejtorin për prezantimin e kësaj informate por më intereson lidhur me dëgjimet buxhetore që u përmenden këtu po për fat të keq kërkosat e komuniteteve pakicë nuk janë përfillur në masën e duhur për disa vite me radhë p.sh. është ngritur disa herë kubëzimi në rrugën Musa Zajmi në të cilën kalojnë përvèç komuniteteve me mijëra nxënëse dhe janë disa institucione publike në këtë rrugë prandaj unë kërkoj sqarime edhe një herë nga ju se kur është planifikuar që të realizohet ky projekt dhe kërkoj që të merren parasysh edhe kërkosat e komunitet rom dhe jo vetëm të komuniteteve tjera. Po bashkëngjitëm me parafolësen lidhur me rrezikshmérinë për nxënësit që shkojnë në shkollën Ahmet Rustemi në Bec sepse nuk ka trotuare dhe fëmijët detyrohen të kalojnë në rrugë të makinave dhe paraqet shumë rrezik për jetën e tyre si dhe për rrugën Martirët Dinaj ne nuk kemi pare që kanë filluar punimet në këtë rruge dhe aty nuk mundet të realizohet asfaltimi para se të përfundohet kanalizim për shkak se kjo lagje nuk është e lidhur me kanalizim.

z. Shkumbim Kastrati: Për rrugën Musa Zajmi mund të kontaktoni edhe me z. Behluli në ZKKK që është në dijeni me projektet në bashkëfinancim të qeveris. Edhe një herë po kërkoj që të merrni pjesë

në dëgjimet buxhetore dhe ti shprehni kërkesat e juaja të cila do të merren parasysh për të hyrë në buxhetin e viti të ardhshëm.

z. Armend Behluli: Ne si ZKKK kemi marrë disa kërkesa të vazhdueshme të komuniteteve dhe kemi dal në teren me inxhinierët e komunës dhe kemi bërë matje të projekteve infrastrukturor, kemi kontaktuar edhe me drejtorin e financave për financimin e këtyre projekteve mirëpo nuk kanë qenë të planifikuar për këtë vit dhe jemi duke punuar të gjemë një formë për financimin e këtyre projekteve janë disa projekte që janë shumë të rëndësishme për komunitete dhe që kërkohet qe sa me pare të behet realizimi i tyre.

Kryesuesi: E falënderoj z. Behluli dhe ne si komitet çdo herë në teren e ftojmë ZKKK andaj kërkojmë që edhe ju të na ftoni neve si komitet që bashkërisht të dalim në teren.

z. Emrah Cermjani: Ne në vazhdimësi i kemi diskutuar me ju z. Behluli këto problem dhe nuk është në rregull që sot këtu të thuani nuk kemi pasur kërkesa ne si zyre.

zpj. Ermira Morina: Sa i përket rrugës Martirët Dinaj unë kërkoj nga drejtori që së bashku me kanalizimin të përfundoj edhe asfaltimi i kësaj rruge.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera po vazhdojmë te pikë e radhës e rendit të ditës.

3. Pika e tretë e rendit të ditës: Raporti i zyrës Komunale për Komunitet dhe Kthim (ZKKK).

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës kemi Raporti i zyrës komunale për komunitete dhe kthim, prezentë e kemi përfaqësuesin e ZKKK-së z. Armend Behluli e ftojë që ta merr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

z. Armend Behluli: Sa i përket thirrjet nga MAPL thirrja ka qenë për ndërtime, renovime si thirrje të tjera që kanë të bëjnë me projekte të infrastrukturës pastaj është edhe një thirrje tjetër ndër komunale si për projekte socio ekonomike, qendra në Brekoc ka aplikuar dhe parashihet që edhe qendra në Ali Ibra të aplikoj për renovim sepse është në gjendje jo të mirë ne si ZKKK ju kemi asistuar rreth 50 familjeve për mbushjen e aplikacioneve rreth thirrjes për ndërtimin dhe renovimin e shtëpisive thirrja vazhdon të jetë e hapur deri të Premten dhe kanë aplikuar një numër i konsiderueshëm i komuniteteve. Për projektet infrastrukturor komuna ende nuk ka aplikuar me cilat projekt do të kërkohet për ti realizuar.

zpj. Ermira Mehmeti: Unë kamë një pyetje në lidhje me rrugën Hysen Mehmeti e cila nga hotel presidenti e deri tek ura është e përfunduar andaj a është e mundur që edhe pjesa tjetër të përfshihet me projekte me bashkëfinancim nga ministria.


zpj. Ifeta Jakupi: Unë kërkoj sqarime lidhur me aplikimet që i kemi bërë në ministri që më shumë se dy muaj dhe ende nuk kemi marrë përgjigje a keni ndonjë informatë në lidhje me këtë çështje.

4. Pika e katërt e rendit të ditës: Të ndryshme.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi të ndryshme a ka ndonjë diskutim lidhur më këtë pikë të rendit të ditës.

Meqenëse nuk ka diskutime tjera e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 14:40.

Procesmbajtëse

Mimoza Brovina

Kryesuesi i Komitetit

z. Ergit Qeli